PLANI I VEPRIMIT PËR TRANSPARENCË
2019-2023

Deçan, Maj , 2019

REPUBLIC OF KOSOVA
K.K-Deçan-AS 18618
01 12-06-2019

Përmbajtja:

Hyrje	3
Njoftimet për mbledhjet e Kuvendit të Komunës së Deçanit dhe të komiteteve	4
Mbledhjet e hapura të Kuvendit të Komunës së Deçanit dhe të komiteteve	4
Mbledhjet e Kuvendit se shpejti transmetohen direkt për qytetarët nëpërmjet "livestream"	4
Përgatitja e informative pas përfundimit të mbledhjeve të Kuvendit të Komunës	5
Publikimi i procesverbaleve të Kuvendit të Komunës dhe të Komitetit për Politik e Fin.	5
Publikimi i akteve të miratuara nga Kuvendi i Komunës	5
Dëgjimet publike buxhetore	5
Takimet me qytetarë	6
Konsultimi I publikut para miratimit të akteve	6
Qasjane ne dokumente publike	6
Parashtrimi i kërkesës së qytetarëve për qasje në dokumente zyrtare, I digjitalizuar	7
Takimet e Kryetarit të Komunës me qytetarë	7
Përditësimi me informata ueb-faqes zyrtare të Komunës së Deçanit dhe platformës– "online"	7
Prokurimi transparent	7
Transparencë e plotë në punësim	8
Hapja e të dhënave në dispozicion të qytetarëve–"OPENDATA"	8
Aplikacioni mobil –"E-shpenzimet"	8
Njoftimi i qytetarëve nëpërmjet mesazheve telefonike	9
Infografikat	9
Faqet zyrtare të Komunës së Deçanit në rrjetet sociale	9
Qasje e shpejtë dhe transparente e qytetarëve në shërbimet digjitale	9
Platforma digjitale për participim të publikut (qytetarëve)	10
Qytetariaktiv– "E-inspeksioni"	10
Transparencanë Kulturë	10

HYRJE

Hapja e Komunës për qytetarë e lehtëson transparencën e qeverisjes në Komunën e Deçanit, llogaridhënien dhe pjesëmarrjen e publikut në proces të vendimmarrjes.

Ne, në Komunën e Deçanit ,transparencën komunale e quajmë dimension jetik të qeverisjes lokale, në mënyrë që ajo të bëhet ashtu siç duan ta kenë qytetarët e Deçanit , me qëllim që t'i besojnë asaj një qeveri demokratike, të hapur, transparente, efektive dhe efikase.

Përmes politikave dhe masave të marra, Komuna po bën përpjekje për të rritur efikasitetin, trajtimin dhe cilësinë e shërbimeve publike, ashtuqë qytetarët ta rrisin besueshmërinë në qeverisjen lokale dhe besimin në atë se zëri i tyre dëgjohet në Komunë.

Në bazëtë nenit 12.1dhe 12.2, pika **d**, të Ligjit nr. 03/L-040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës",nr. 28/2008) dhe të Udhëzimit administrative (MAPL) Nr.04/2018, për transparence në komuna dhe legjislacionin tjetër në fuqi, me propozimin e Kryetarit të Komunës së Deçanit, Kuvendi I Komunës në mbledhjen e mbajtur me dt.31.05.2019, miraton këtë Plan të veprimit për transparencë katër (4) vjeçar të Komunës, i cili përmban këto objektiva:

Objektivat e planit të veprimit

1. Njoftimet për mbledhjet e Kuvendit të Komunës së Deçanit dhe të komiteteve

Lidhur me njoftimet për mbledhjet e Kuvendit të Komunës së Deçani , Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Komitetit për Komunitete, Komuna e Deçanit i njofton qytetarët 7 ditë pune para mbledhjeve të rregullta dhe 3 ditë pune para mbledhjeve të jashtëzakonshme, siç është e përcaktuar në nenin 4, pika 3dhe 4 e Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.04/2018,për transparencë në komuna.

2. Mbledhjet e hapura të Kuvendit të Komunës së Deçanit dhe të komiteteve

Mbledhjet e Kuvendit të Komunës dhe të komiteteve janë të hapura për publikun, për zyrtarët monitorues të OJQ-ve që e përcjellin punën e Kuvendit, si dhe për subjektet e caktuara, të cilat janë objekt i pikes së rendit të ditës. Materiali i mbledhjeve të Kuvendit u dërgohet edhe zyrtarëve monitories të OJQ-veqë e përcjellin punën e Kuvendit , por edhe të subjekteve të caktuara, të cilat janë objekt i diskutimit në kohën e njëjtë me atë të asamblistëve, në mënyrë që të jenë të informuar saktë dhe korrekt për çdo gjë që do të diskutohet në atë mbledhje.

3. Mbledhjet e Kuvendit do të transmetohen drejtpërdrejt për qytetarët nëpërmjet "livestream"

Mbledhjet e Kuvendit te Komunës do të transmetohen drejperdrejtë për qytetarët ne web-faqen zyrtare te Komunës dhe ne Facebook te Komunës, nepërmjet "LIVE Stream" duke shfrytëzuar programin e Youtube. Keto transmetime pastaj janë te ruajtura ne Arkiven e web-faqes zyrtare dhe qytatarët mund ti shohin ne çdo kohë.

4. Përgatitja e informatave pas përfundimit të mbledhjes së Kuvendit të Komunës

Pas përfundimit të mbledhjes së Kuvendit të Komunës, Zyra për informim është përgjegjëse ta përgatis lajmin lidhur me zhvillimet në kuadër të mbledhjes rreth pikave të caktuara të rendit të ditës,në mënyrë që qytetarët të jenë mirë të informuar. Lajmi publikohet në ueb- faqen zyrtare të Komunës së Deçanit dhe ne rrjete sociale...

5. Publikimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Kuvendit të Komunës dhe të Komitetit për Politikë dhe Financa

Pas përfundimit të mbledhjeve, Shërbimi i Kuvendit është i obliguar të shkruajë transkriptin e mbledhjeve dhe në bazë të tij të përgatis procesverbalin.Procesverbalet së pari duhet të votohen në Kuvendin e Komunës dhe në Komitetin për Politikë dhe Financa.Pas kryerjes së kësaj procedure, publikohet në ueb-faqen zyrtare të Komunës së Deçanit .

6. Publikimii akteve të miratuar nga Kuvendi i Komunës

Të gjitha vendimet, rregulloret dhe dokumentet tjera të Kuvendit të Komunës, publikimi i të cilave nuk kufizohet sipas Ligjit përkatës për qasje në dokumente publike, bëhen publike dhe të qasshme për publikun pas vlerësimit të ligjshmërisë nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL).Të gjitha këto akte publikohen në ueb-faqen zyrtare të Komunës së Deçanit .

7. Dëgjimet buxhetore

Në muajin gusht të çdo viti, Komuna e Deçanit organizon dëgjime publike buxhetore me qytetarë, për çdo fushë, në mënyrë që të përfshihen qytetarët në procesin e vendimmarrjes për hartimin e buxhetit të vitit pasues.

8. Takimet publike me qytetarë

Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr. 04/2018, për transparencë në komuna, neni 10 pika 1, e parasheh që Komuna ç'do vit duhet të mbajë së paku dy takime publike me interes të përgjithshëm.
Njoftimet për këto takime publikohen në ueb-faqen zyrtare të Komunës së Deçanit së paku dy javë përpara mbajtjes së takimit, si dhe tabelat e shpalljeve publike në qytet dhe keshillat lokal. Pas përfundimit të takimeve , Zyra për informim është përgjegjëse të përgatis lajm për këtë, ashtu që qytetarët të jenë të informuar për pikat të cilat janë diskutuar.

9. Konsultimi i publikut para miratimit të akteve

Komuna e Deçanit organizon diskutime publike me qytetarë para miratimit të akteve që janë më interes për qytetarët. Rekomandimet e paraqitura nga ana e qytetarëve shqyrtohen nga ekspertët e çështjeve të caktuara, pastaj ato rekomandime përfshihen në aktin i cili dërgohet në Kuvend për miratim.

10. Qasja në dokumente publike

Për të qenë sa më transparent ndaj qytetarëve, Komuna e Deçanit në ueb-faqen zyrtare të Komunës së Deçanit , në menynë "Çasja në dokumentet publike",i ka të publikuara informatat e personave kontaktues për qasje në dokumente zyrtare. Secili qytetar ka të drejtë të bëjë kërkesë për qasje në dokumente zyrtare. Formulari i kërkesës për qasje në dokumente zyrtare është publike në ueb-faqen zyrtare të Komunës së Deçanit .Formulari dorëzohet në zyra te Qendrës për shërbim me qytetarë (QSHQ).Të gjitha kërkesat për dokumente zyrtare, personat përgjegjës të QSHQ-së ua dorëzojnë personave përgjegjës për procedimin e këtyre kërkesave për qasje në dokumente publike.Të gjitha kërkesat trajtohen në mënyrë të barabartë dhe shqyrtohen sipas afatit.

11.Takimet e Kryetarit të Komunës me qytetarë

Kryetari i Komunes se Deçanit e ka te caktuar nje ditë ku i mbanë takimet me qytetarë sipas radhes qe janë paraqitur...pas takimeve kabineti i Kryetarit e publikon nje informatë të shkurt permes Zyres per Informim në web-faqen e Komunës.

12. Përditësimi i informative në ueb-faqes zyrtare të Komunës së Deçanit

Ueb-faqja zyrtare e Komunës së Deçanit plotësohet çdo ditë me informata, sipas Udhëzimit administrative (MAP) Nr.01/2015 për ueb-faqete institucioneve publike. Këto informata përfshijnë: lajme rreth aktiviteteve ditore, njoftime për takime publike, konkurse, projekte kapitale, raporte financiare, informata të drejtorive,udhëzues për qytetarë etj.

13. Prokurimi transparent

Komuna e Deçanit në ueb-faqen e saj zyrtare dhe,në afat kohor duhet të publikoj:

- Planin e prokurimit,
- Raportin për kontratat e nënshkruara sipas viteve,
- Njoftimet për kontrata,
- Njoftimet për dhënien e kontratave,
- Njoftimet për konkurs të projektimit,
  Njoftimet për anulimi

  Njoftimet për informata shtesë,
- Njoftimet për nënshkrimin e kontratës dhe
- Njoftimet për anulimin e dhënies së kontratës.

14.Transparencë e plotë në punësim

Zyra e personelit është përgjegjëse për publikim në ueb-faqen zyrtare të Komunës së Deçanit , në objektin e Komunës dhe në mediat e shkruara,të njoftimit për konkurs, të listës së ngushtë për testin me shkrim, të listës për intervistë me gojë, të vazhdimit të konkursit dhe të anulimit të konkursit.- Pas pranimit te kandidatit/es pubikohen te dhenat e rezultatit të konkursit…

15.Njoftimi i qytetarëve nëpërmjet mesazheve telefonike

Sistem për dërgimin e mesazheve nga Komuna e Deçanit për njoftimin e qytetarëve rreth çështjeve të caktuara.

16. Faqet zyrtare të Komunës së Deçanit në rrjetet sociale

Komuna e Deçanit e ka të hapur faqen e saj zyrtare në "facebook"," ku i informon qytetarët për aktivitetet e Komunës.

17.Qasje e shpejtë dhe transparente e qytetarëve në shërbimet digjitale

Komuna e Deçanit në qendër të vëmendjes e ka qytetarin dhe lehtësimin e qasjes së qytetarit në shërbimet që i ofron Komuna. Komuna i publikon në ueb-faqen zyrtare të gjitha informatat e nevojshme për qytetarë, në mënyrë që ai të pajiset me dokumente të caktuara. Janë publike: udhëzuesit,broshurat. Regjistrimi i procedurave administrative në Komunën e Deçanit ", ku e informon qytetarin edhe për detajin më të vogël rreth pajisjes me një dokument të caktuar.

18. Plani i transparences do të ndryshohet dhe plotësohet sipas nevojës.
Ne vitet në vijim do te funkcionalizohen edhe" Platforma digjitale", "Open Data", "Aplikacioni digjital per telefona te menqur", "E-prokurimi", "E-Shpenzimi" si dhe forma tjera të Komunikimit me qytetaret për të rritur transparencën .

Nr.	Objektivate Planit të veprimit	Aktivitetet e planit të transparencës	Personi përgjegjës për publikimin e dokumenteve dhe aktiviteteve të Komunës	Vendii mbajtjes së aktiviteteve	Afatat ligjore publiketë dokumenteve dhe aktiviteteve të organeve Komunës.
1	**Njoftimet për mbledhje te Kuvendit të Komunës së Deçanit dhe të komiteteve**	Njoftimet për mbledhjet E rregullta të Kuvendit të Komunës dhe të komiteteve në: - ueb-faqen zyrtare dhe platformën "... online", - vendet më të frekuentuara brenda territorit të komunës, - mediat e shkruara dhe elektronike, - rrjetesociale	Sekretaria e Kuvendit njofton – Zyren e Informimit Publik te krijon njoftimin për qytetarë.	Salla e Kuvendit të Komunës/ komiteteve	7ditëpara mbledhjeve të rregullta dhe 3 ditë para mbledhjeve të jashtëzakonshme
2	**Mbledhjet e hapura të Kuvendit të Komunës së Deçanit dhe komiteteve**	Mbledhjet janë të hapura për publikun, zyrtarët monitorues tëOJQ-veqë e përcjellin punën e Kuvendit, por edhe subjektet e caktuara që janë object diskutimi në ndonjë pike të rendit të ditës	Sekretaria e Kuvendit I njofton për mbledhjen personate caktuar dheju përcjell dokumentet që do të diskutohen.	Salla e Kuvendittë Komunës/ komiteteve	
3	**Mbledhjet e Kuvendit sw shpejti do tw nisin tw transmetohwn drejtpërdrejt për qytetarët nëpërmjet "livestream"**	Mbledhjet e Kuvendit sw shpejti do tw transmetohen drejtpërdrejt nëpërmjet kanalit zyrtar të Komunës së Deçanit në "youtube", në ueb-faqen zyrtare të Komunës,si dhe nëpërmjet shpërndarjes së linkut	- Zyra e Informimit Publik.	Salla e Kuvendit të Komunës	Nëditëte mbajtjessë mbledhjes

4	**Përgatitja e informative pas përfundimit të mbledhjes së**	Përgatitja e informatave pas çdo mbledhje të Kuvendit për mediat e shkruara dhe elektronike. Komunikata publikohet	Zyra përInformim		Pas përfundimit të mbledhjes

Nr.	Objektivate planittë veprimit	Aktivitetet e planittë transparencës	personi përgjegjëspër publikimine dokumenteve dheaktiviteteve të Komunës	Vendii mbajtjes së aktiviteteve	...tatetigjd për shpallje publiketë dokumenteve dheaktiviteteve të organeve Komunës.
	Kuvendit të Komunës	Në ueb-faqen zyrtaretë Komunës sëDeçanit , platformën "...online", si dhe në rrjetet sociale të komunës së Deçanit.			
5	**Publikimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Kuvendit të Komunës dhe të Komitetit për Politikë dhe Financa**	Procesverbalet së pari votohen në Kuvendin e Komunës.Pas kryerjes së kësaj procedure, publikohen në ueb-faqen zyrtare të Komunës së Deçanit dhe platformën "... online".	Procesverbalet shkruhen nga Zyra e kuvendit, kurse publikohen në ueb-faqen zyrtare tëKomunës dhe platformën "... online" nga Zyra e Informimit Publik		Pas miratimit në Kuvendin e Komunës
6	**Publikimi i akteve të miratuara nga Kuvendi i Komunës**	Publikohen në ueb-faqet e Komunës 15 ditë pas dërgimit të tyre në MAPL.	Zyra e Kuvendit aktet i përcjell te zyrtari për Teknologji Informative,i cili e publikon pastaj në ueb-faqen zyrtare të Komunës së Deçanit dhe platformën "... online"		
7	**Dëgjimet buxhetore**	Dëgjimet publike Buxhetore mbahen me qëllim të përfshirjes së qytetarëve në procesin e vendimmarrjes për hartimin e buxhetit për vitin e ardhshëm	Kabineti i Kryetarit	Objekti i Komunës së Deçanit. Ne bashkesi Lokale	2 javë para mbajtjes së takimit. Sipas orarit te takimeve

8	**Takimet publike me qytetarë**	Kryetari I Komunës së Deçanit mban së paku dy takime publike për çështjet e interesit të	Zyra e Kryetarit, përmes Zyres se Informimit Publik	Varësisht prej temave që diskutohen	Njoftimi 2javë para mbajtjes

Nr.	Objektivate planittë veprimit	Aktivitetet e planittë transparencës	Personi përgjegjëspër publikimine dokumenteve dheaktiviteteve të Komunës	Vendii mbajtjes së aktiviteteve	Afatetligjo për shpallje publiketë dokumenteve dheaktiviteteve të organeve Komunës.
		përgjithshëm, si dhe shumë takime të tjera për çështje të caktuara.	Njofton qytetarët së paku dy javë përpara mbajtjes së takimeve publike,si dhe dëgjimevetë ndryshme,në ueb faqen zyrtare, platformën "...online", në vendet mëtë frekuentuara brenda territorit Të komunës, në media të shkruara dhe elektronike dhe rrjetet sociale.		
9	**Konsultimi i publikut para miratimit të akteve**	Komuna eDeçanit sorganizon konsultime para miratimit të akteve që janë me interes për qytetarë. Rekomandimet eparaqitura nga ana e qytetarëve përfshihen në akt.	Sekretaria Kryetarit,përmes zyrtarit për komunikim me publikun njofton qytetarët së paku dy javëpërpara mbajtjes së takimeve publike si dhe dëgjimeve të ndryshme edhe atë në ueb- faqen zyrtare, platformën "...online" në vendet më të frekuentuara brenda territorit Të Komunës, në media të shkruara dhe elektronike dhe në		Njoftimi 2 javë para mbajtjes

Nr.	Objektivate planittë veprimit	Aktivitetet e planittë transparencës	personi përgjegjëspër publikimine dokumenteve dheaktiviteteve të Komunës	Vendi mbajtjes së aktiviteteve	për shpallje publiketë dokumenteve dheaktiviteteve të organeve Komunës.
			rrjetesociale		
10	**Qasja në dokumente publike**	Për të qenë sa më transparent ndaj publikut, Komunae Deçanit bën pranimin Dhe shqyrtimin fillestar të kërkesave për qasje në dokumente publike, të aprovuara nga organete Komunës,dhei adreson ato në pajtueshmëri me Ligjinnr. 03/L-215,për qasje në dokumente publike.	Zyrtari përgjegjës për qasje në dokumente publike		7-15ditë
11	**Parashtrimi i kërkesës së qytetarëve për qasje në dokumente zyrtare,i digjitalizuar**	Qytetarët mund të aplikojnë "online" për qasje në dokumente publike dhe me anë të email-it të njoftohen për tërheqjen e dokumentacionit të kërkuar.	Zyrtari përgjegjës për qasje në dokumente publike		7-15ditë
12	**Takimet e Kryetarit të Komunës me qytetarë**	Kryetari mban takime me qytetarë sipas kërkesave të adresuara nga ana e qytetarëve.			
13	**Përditësimi me informata I ueb-faqes zyrtare të Komunës së Deçanit dhe platformës "...online"**	Ueb-faqja zyrtare e Komunës së Deçanit dhe platforma "...online", freskohet me lajme e informacione nga aktivitetete përditshme të ekzekutivit dhe vendimmarrjes, si dhe material tjera publike sipas udhëzimit AdministrativNr. 01/2015.	Përgjegjëse për këtë është Zyra informim publik		

Nr.	Objektivate planittë veprimit	Aktivitetet e planittë transparencës	personi përgjegjëspër publikimine dokumenteve dheaktiviteteve të Komunës	Vendii mbajtjes së aktiviteteve	strategjiq për shpallje publiketë dokumenteve dheaktiviteteve të organeve Komunës.
14	**Prokurimi transparent**	Publikohen të gjitha njoftimet për kontrata, njoftimet për dhënien e kontratave,njoftimin për anulim, njoftimet për informata shtesë,si dhe njoftimet për anulimin e dhënies së kontratës.	Përgjegjës për publikim të tyre Në ueb-faqe është Zyra e Informimit publik		Sipas afateve ligjore
15	**Transparencë e plotë në punësim**	Zyra e personelit është Përgjegjëse për publikim në ueb-faqen zyrtare të Komunës së Deçanit, platformën "...online", në objektin eKomunës dhe në mediat e shkruara,të njoftimit për konkurs,të listës së ngushtë për testin me shkrim, të listës për intervistë me gojë,të vazhdimit të konkursit Dhe të anulimit të konkursit.	Zyra e personelit, në bashkëpunim me zyrtarinë për teknologji informative		Sipas afateve ligjore
16	**Hapja e të dhënave në dispozicion të qytetarëve– "OPENDATA"**	Përmes platformës "online"tëhapjes së të dhënave ose"open data", që është në funksion të transparences dhe zhvillimit lokal,do të bëhet vizualizimi i të gjitha informacionevetë mbledhura nga drejtoritë komunale,me qëllim që këto shënime të përdoren më tutje në funksion të transparences së plotë	Zyrtari I teknologjisë informative		

Nr.	Objektivate planittë veprimit	Aktivitetet e planittë transparencës	personi përgjegjës për publikimine dokumenteve dheaktiviteteve të Komunës	Vendi mbajtjes së aktiviteteve	Strategjia për shpallje publiketë dokumenteve dheaktiviteteve të organeve Komunës.
		Komunë dhe në funksion të zhvillimit lokal.			
17	**Aplikacioni mobil -"E-shpenzimet"**	Aplikacionicili Shkarkohet dhe instalohet në telefonat e mençur mobilë,I cili tregon për lajmet me të reja nga Komuna, shpenzimet e Komunës të ndara në Skategori Buxhetore (subvencionet dhe transferet, shpenzimet kapitale, shpenzimet komunale, mallrat dhe shërbimet,	Njoftimet dërgohen nga Zyra përmedia, shpenzimete Komunësnga Drejtoriae Financave,kurse publikiminetyre nëaplikacione bën zyrtari për teknologji informative	??????????	
18	**Njoftimi i qytetarëve nëpërmjet mesazheve telefonike**	Sistem për dërgimin e mesazheve nga Komuna e Deçanit për njoftimin e qytetarëve rreth çështjeve të caktuara.	Drejtoria e Administratës		

Nr.	Objektivate planittë veprimit	Aktivitetet e planittë transparencës	personi përgjegjëspër publikimine dokumenteve dheaktiviteteve të Komunës	Vendii mbajtjes së aktiviteteve	për shpallje publiketë dokumenteve dheaktiviteteve të organeve Komunës.
19	**Infografikat**	Tabela informuese për Drejtorinë e Administratës, Drejtorinë e Kadastrit, Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe Drejtorinë e Urbanizmit, E cila ofron të dhëna se ku duhet të drejtohen qytetarët,cilat dokumente u nevojiten për çdolloj të vërtetimit ose dokumentit që lëshon Komuna. Të njëjtat janë publike edhe në ueb-faqen zyrtaretë Komunës së Deçanit dhe platformën "... online"	Drejtoria e Administratës		
20	**Shfrytëzimii rrjeteve sociale**	Tëgjitha aktivitetet e Komunës së Deçanit publikohen në "facebook","	Zyra për media		
21	**Qasje e shpejtë dhe transparente e qytetarëve në shërbimet digjitale**	Komuna eDeçanit në Qendër të vëmendjes e ka qytetarin dhe lehtësimin e qasjes së qytetarit në shërbimet që i ofron Komuna. Komuna i publikonnë ueb-faqen zyrtare të gjitha informatat e nevojshme për qytetarë,në mënyrë që ai tëpajiset me dokumentet e caktuara.	Drejtoria e Administratës		

Nr.	Objektivate planittë veprimit	Aktivitetet e planittë transparencës	personi përgjegjës për publikimine dokumenteve dheaktiviteteve të Komunës	Vendi mbajtjes së aktiviteteve	për shpallje publiketë dokumenteve dheaktiviteteve të organeve Komunës.
		broshurat, si dhe platform "Regjistrimii procedurave administrative në Komunën eDeçanit ", ku e informon qytetarin edhe për detajin më të vogël rreth pajisjes me një document të caktuar.			
22	**Platforma digjitale për participim të publikut (qytetarëve) –**	Qytetarët të gjitha kërkesat e tyre për lagjen ku jetojnë I bëjnë në këtë platformë. Kërkesat shqyrtohen nga ana e zyrtarëve komunalë. Ato kërkesa të cilat kanë vota më shumë nga qytetarët, merren parasysh në hartimin e buxhetit për	Drejtoria e Administratës		
23	**Qytetariaktiv – Për Deçanin**	Aplikacion ku qytetarë ti paraqesin parregullsitë dhe mos respektimin e ligjit.	Drejtoria e Inspekcionit		
24	**Transparencanë Kulturë**	Platformë për të aplikuar "online"për subvencione,si dhe përcjellje ne gjithë procesit të aplikimit	Drejtoria e Kulturës, Rinis dhe Sporteve		

https://kk.rks-gov.net/decan/

01.Nr.V-5

Deçan,dt.31.05.2019

Kryesuesi i Kuvendit:

Haki Shehaj

REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIKA E KOSOVËS • OPŠTINA DEČANI • OPŠTINA DEČANE • Skupština Opštine • Komunal Assembly • Kuvendi Komunal • KOMUNA DEÇANIT • REPUBLIC OF KOSOVA • DEÇANI MUNICIPALITY •

REPUBLIC OF KOSOVA
DEÇAN MUNICIPALITY

K.K.Deçan.AS 1818
01
12.06.19